



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

Pranuar me: 17-06-202			
Nj. org.	Numer	Shtoiça	Viteja
03	3501	3	-

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti

i Filologjisë

Lëndët

*Shekspiri, Interpretimi i veprave
letrare, Letërsi moderne
amerikane, Pasqyrë e letërsisë
amerikane deri në vitin 1990,
Metodologji e punës kërkimore
shkencore.*

Kandidatët e paraqitur

Lurjana Krasniqi
Ardita Ibishi

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. asoc. dr. Lindita Tahiri
Prof. ass. dr. Blerta Mustafa
Prof.ass.dr. Lendita Kryeziu



SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

MA Lurjana Krasniqi, e lindur më 2 maj 1996, ka mbaruar studimet me sukses të shkëlqyeshëm në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze të Fakultetit të Filologjisë të UP-së, në BA për gjuhë e letërsi me notë mesatare 9.42, dhe në MA për letërsi me notë mesatare 9.31. Është studente në programin e doktoratës për letërsi në Fakultetin e Filologjisë të UP-së nga viti 2020.

- I plotëson kushtet e paraqitura në konkursin me nr. prot. 1/217 të datës 1/6/2022.

- I plotëson kushtet e paraqitura në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

- Ka qenë e angazhuar si asistente gjatë vitit akademik 2021/2022 për një sërë lëndësh nga letërsia. Në dosje figuron kontrata e punës për angazhim me honorar në fakultetin e Filologjisë si vijon:

Kontrata fillon me 1.10.2021 dhe mbaron me 30.09.2022 (Nr. prot. 1/713 date 1/10/2021) Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës.

Propozohet për këtë pozitë sepse ka përvojë në mbajtjen e ushtrimeve nga fusha përkatëse që një vit, por edhe i përmbush kërkesat e tjera të parashtruara në konkurs si vijon:

-Ka ofruar dëshmi për përvojë pune në mësimdhënie universitare dhe parauniversitare.

-Performanca në mbajtjen e ushtrimeve nga fusha përkatëse ka qenë e shkëlqyer.

-Ka ofruar dëshmi për publikime shkencore. Ka të botuar 1 publikim shkencor në një revistë shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik.

-Ka notë mesatare më të lartë në studimet BA dhe MA.

-Në CV-në e saj ka të shënuara një numër të konsiderueshëm të trajnimeve për zhvillim profesional.

-Përparësitë: përvojë pune në fushën dhe pozitën përkatëse, në përputhje me Nenin 4.1 të Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", 1 publikim shkencor në përputhje me Nenin 2.2 të Rregullores në fjalë, si dhe nota mesatare me e lartë në të dyja nivelet.

MA Ardita Ibishi, e lindur më 22 nëntor 1994, ka mbaruar studimet me sukses të shkëlqyeshëm në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze të Fakultetit të Filologjisë të UP-së, në BA për gjuhë e letërsi me notë mesatare 8.90, dhe në MA për letërsi me notë mesatare 9.15. Është studente në programin e doktoratës për letërsi në Fakultetin e Filologjisë të UP-së nga viti 2018.

- I plotëson kushtet e paraqitura në konkursin me nr. Prot. 1/217 të datës 1/6/2022.

- I plotëson kushtet e paraqitura në nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

- Ka ofruar dëshmi për përvojë pune në mësimdhënie universitare: ka qenë e angazhuar si asistente e gjuhës angleze në Universitetin e Mitrovicës si dhe lektore e gjuhës angleze në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Fakultetin e Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, por jo në disiplina letrare për të cilat është shpallë konkursi.

- Është në pritje të një botimi në revista përkatëse ndërkombëtare në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik, por punimi ende nuk është publikuar edhe pse ka konfirmim nga revista.

-Ka notë mesatare më të ulët në të dyja nivelet.

-I mungon përvoja në mësimdhënie në fushën adekuate gjë që plotësohet nga kandidatja e propozuar në këtë pozitë.

Komisioni propozon që kandidatja MA Lurjana Krasniqi të angazhohet për pozitën 21 te angazhimet për Fakultetin e Filologjisë - bashkëpunëtores e jashtme për ushtrime për lëndët *Shekspiri, Interpretimi i veprave letrare, Letërsi moderne amerikane, Pasqyrë e letërsisë amerikane deri në vitin 1990, Metodologji e punës kërkimore shkencore* - të konkursit të UP-së të datës 1 qershor 2022. Lurjana Krasniqi e ka notën më të lartë në studimet master për letërsi nga dy kandidatet e paraqitura në konkurs dhe ka publikim në platformën Scopus. Në veçanti, kandidatja Lurjana Krasniqi ka qenë e angazhuar gjatë një viti akademik dhe ka pasur performancë të shkëlqyer në punën me studentë gjatë ushtrimeve në lëndët përkatëse të shpallura me konkurs.

Rrjedhimisht, Komisioni refuzon kandidaten MA Ardita Ibishi për pozitën e sipërpërmendur në konkurs, mbasi kandidatja MA Lurjana Krasniqi rangohet më lart në këtë vlerësim, bazuar në kriteret e konkursit të UP-së.

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtare
3. Anëtare

Prof. asoc. dr. Lindita Tahiri

Prof. ass. dr. Blerta Mustafa

Prof. ass. dr. Lendita Kryeziu

Prishtinë, 16.06.2022